



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1251

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “STORM ICT” L.L.C., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kompjuter dhe laptopa per nevoja te DSISH” me numër të prokurimit; 206-24-11609-5-5-8, me 12/03/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “STORM ICT” L.L.C. me nr. 2024/1251, e datës 20/12/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kompjuter dhe laptopa per nevoja te DSISH” me numër të prokurimit; 206-24-11609-5-5-8, AK/Ministria e Shëndetësisë.
2. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 02.12.2024, Ministria Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1 (një) të vendimit.
3. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ligjore ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE “STORM ICT” L.L.C, aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 04.11.2024, “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Ftesen për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me kompjuter dhe laptopa për nevoja të DSISH” me nr. të prokurimit: 206-24-11609-5-5-8. Ndërsa me datën 02.12.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. OE Aritech Sh.P.K. - Graçanicë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 390,000.00 €.

Me 06.12.2024, “STORM ICT” L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 12.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.12.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “STORM ICT” L.L.C., me nr. 2024/1251 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me kompjuter dhe laptopa për nevoja të DSISH” me nr. të prokurimit 206-24-11609-5-5-8.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “STORM ICT” L.L.C., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues (Ministria e Shëndetësisë) pas analizimit të ofertave ka derguar tek Operatorët Ekonomik Njoftimin për vendimin e AK-se, ku shpërblen me kontratë OE: Aritech SH.P.K.

Ne pas kërkesës për casje në dokumentacionin e ofertuesëve, konkretisht OE Aritech SH.P.K dhe pas analizimit të ofertës se tyre kemi vërejtur se oferta e OE nuk është e përgjegjeshme dhe nuk është në përputhje me specifikat minimale të kërkuara në ftesën për ofertim të derguar nga AK (Ministria e Shëndetësisë). Pretendimet tona janë si më poshtë:

Pika 1.: Sipas Aneksit 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, AK ka kërkuar specifikat baze sipas kontratës së AQP-se me nr. të kontratës UA/2016-24-3927-1-1- 1/C549 deri C568, dhe ka kërkuar disa specifika më të avancuara si në tabelën më poshtë:

Pas analizimit të ofertës së OE: Aritech SH.P.K kemi vërejtur se OE nuk është në përputhje me kërkesën e AK-se.

Brand Name PC Model I:

Sipas ofertës teknike të dorëzuar, OE në fjalë ka ofertuar modelin “HP ProTower 290 G9” i cili nuk ka portë HDMI+DP por ka portet HDMI+VGA, ku edhe sipas katalogut zyrtar të dorëzuar

ka nenvizuar modelin “HP ProTower 290 G9” I cili shihet qarte se ne pjesen mbrapa nuk ka porte HDMI + DP por vetem HDMI + VGA, gjithashtu nuk e ka portin DP si port opsional qe mund te shtohet gjate konfigurimit nga prodhuesi.

Modeli i cili duhet te ishte i ofertuar dhe qe ploteson specifiken teknike te kerkuar nga AK sa i perket porteve per video eshte “HP ProTower 290 G9 PCI”.

Kurse ne oferten teknike te dorezuar nga OE ka deklaruar se modeli I ofertuar ka portet HDMI+DP, gje qe bie ndesh me katalogun zyrtar te prodhuesit.

Pas pranimit te vendimit te AK-se per kerkesen per ri-shqyrtim, kjo pike kthehet si e pa bazuar me arsyetimin se pas sqarimit te ofertes se OE qe rekomandohet per tu shpallur I sukseshem “ekziston mundesia qe te porositet pajisja me HDMI dhe DP port te integruar, kjo gje mund te gjendet ne katalogun e ofurar si ne printscreen-in e bashkangjitur”.

Pas konsultimin me prodhuesin kemi konfirmim qe pajisja eshte e konfigurueshme me portet HDMI + DP por te modeli “HP ProTower 290 G9 PCI” I cili eshte I ofertuar nga ne si GOE dhe I njejti ka edhe USB Porte te ndryshme prej modelit “HP ProTower 290 G9”. Gjithashtu me poshte mund te gjeni dokumentin zyrtar nga prodhuesi se modeli “HP ProTower 290 G9 PCI” vjen me porte te vidoes baze HDMI + DP, kurse modeli “HP ProTower 290 G9” qe OE ne fjale ka ofertuar sipas edhe katalogut te dorezuar faqe 2 konkretisht eshte e cekur qarte portet HDMI dhe VGA.

Bazuar ne pergjigjen e AK-se per kete pretendim se eshte theksuar: “ ku tek kartela grafike eshte sqaruar se ekziston mundesia qe te porositet pajisja me HDMI dhe DP port te integruar”. Ne kete raste eshte e mundur qe te konfigurohet vetem tek modeli “HP ProTower 290 G9 PCI” dhe jo tek “HP ProTower 290 G9” qe OE ne fjale ka ofertuar, qe nenkupton se keto 2 modele te kesaj platformen perveq porteve te videos kane edhe USB porte te ndryshme nga njera tjetra dhe qe nenkupton se OE qe rekomandohet te shpallet fitues duhet te nderroj modelin gje qe eshte ne kundersizim me ligjin e prokurimit publik.

Bazuar ne datasheet-in e dorezuar nga OE ne fjale qe pretendohet te shpallet fitues verehet se ne baze te USB Porteve te ofertuara dhe modelin te hijezuar eshte ofertuar modeli “HP ProTower 290 G9”, eshte argumentuar ne katalogun e ofertuar ku ne faqen 1 verehet OE ka hijezuar modelin “HP ProTower 290 G9 Desktop PC” gjithashtu ne faqen e pare jane hijezuar “ Front: (4) SuperSpeed USB 5Gbps signaling rate port1”, ne faqen e dyte jane selektuar portet mbrapa “Connector (4) USB 2.0 port” dhe RJ-45 Network, ku ne te njejten faqe jane te specifikuar ne piken 4 dhe 5 portet VGA Port dhe HDMI Port si porte baze qe ky model i ka, me poshte po I bashkangjesim ne printscreen edhe faqet e hijezuara.

Faqja e pare ku jane te hijezuara modeli dhe USB Portet.

Faqja e dyte ku jane te hijezuara portet mbrapa (Rear)

Ne faqen 9 te katalogut te dorezuar nga OE ne fjale, eshte mudnesia e identifikimit te USB porteve te modeleve ne fjale (HP ProTower 290 G9 dhe HP ProTower 290 G9 PCI) duke u saktësuar numri I llojeve I porteve (Front) ne te dy platformat te cilat jane porte baze nga prodhuesi. Me poshte po e bashkangjesim printscreen te kesaj faqe nga katalogu I dorezuar nga OE ne fjale.

Ne kete printscreen mund te verejme se portet e ofertuara nga OE ne fjale (front) “(4) SuperSpeed USB 5Gbps signaling rate port1” jane porte baze te modeleve sikur ne tabelen e po ketij katalogu, qe do te thote se portet e selektuara “(4) SuperSpeed USB 5Gbps 12th Gen PCI signaling rate port1” jane te vlefshme dhe porte baze vetem per modelet 13th/14th Gen NON-PCI si dhe tek modeli.

Kurse per portet mbrapa (rear) edhe njehere sic jane paraqitur ne faqen e dyte portet e modelit HP ProTower 290 G9, ku ne printscreen mund te verehen edhe nje here keto porte.

Gjithashtu ne oferten teknike te dorezuar nga OE per Brand Name PC Model I, eshte bere pershkrimi I USB porteve gabim pasi qe modeli I ofertuar nuk ka 4x USB 3.2 (10Gbps) por i ka 4x 3.1 (5Gbps) sipas katalogut zyrtar te prodhuesit.

Pika 2.: Brand Name PC – Model IV

Modeli i ofertuar nga OE, “HP Elite Tower 800 G9”, sipas katalogut zyrtar te prodhuesit dhe nenvizimeve qe ka bere OE shihet qarte se ky model nuk perkrah diskun 4TB HDD po maksimumi I diskut qe perkrah HDD eshte 2TB.

Kurse OE ne tabelen e specifikemeve teknike ka deklaruar se modeli i ofertuar ka 1TB SSD NVMe M.2 dhe 4TB HDD.

AK ne pergjigjen per kerkesen per ri-shqyrtim, kete pike na pretendon si te pa-bazuar me arsyetimin: “Perderisa ne termat e references nuk eshte specifikuar se kerkohet 1x 4TB HDD, ka qene e pranueshme per komisionin vleresues oferta me 3 disqe ne total me 4TB”.

Ne besojme se ky arsyetim do te kete shume probleme tek perdoruesit e ketyra PC-ve pasi qe per secilen pajisjet do te krijohen 4 hapesira te ndryshme (1x 1TB SSD, 1x 2TB HDD, 1x 1TB HDD dhe 1x 1TB HDD) per ruajtjen e shenimeve.

Ne kerkojme nga Eksperti I OSHP-se qe caktohet per kete lende, te beje verifikim e sakte te ketyre pikave qe ne pretendojme se jane ne kundershtrim me kerkesen e AK-se si dhe te beje verifikimin me prodhuesin te cilin OE ka ofertuar nese produktet ofertuara jane me garancion te plote nga prodhuesi sipas kerkeses se AK-se, pasi qe kerkesa per garancion nga prodhuesi ka qene pjese e kerkeses fillestare per para-kualifikim ne AQP Marreveshjen Kornize me nr. te prokurimit: UA/2016-24-3927-1-1-1 (Aneksi 7 - Formulari i autorizimit të prodhuesit) ku saktesisht kerkohen te dhenat si ne fotografine me poshtë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Përqijja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore Konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore janë te pa bazuara, bazuar ne sqarimet profesionale te komisionit vlerësues - profesionisteve te teknoloqjisë nga DSISH, ju përgjigjemi si me poshtë

- PC Model I

Për modelin I te PC, OE ka ofertuar me Pc te modelit HP Pro Tower 290 G9 Desktop PC, ku tek kartela grafike eshte sqaruar se ekziston mundësia qe te porositet pajisja me HDMI dhe DP port te integruar, kjo gjë mund te gjendet ne katalogun e ofruar si ne printscreen-in e bashkangjitur.

Netërsa sa i përket nr te porteve te kërkuar tek PC Model 1 , janë kërkuar “min 4xUSB 3,0 , 2 x USB 2.0 pra total min 6 porte USB apo me te avancuara”, ndërsa OE ka ofruar ka 4x SuperSpeed USB 5gbps qe do te thotë 4 porte USB 3.1,(janë me te avancuara se 3.0) si dhe 4 xUSB 2.0 , kjo gjë mund te vërtetohet edhe ne katalogun e ofruar, siç shihet ne 2 printscreen e mëposhtëm.

Përderisa ne termave te referencës nuk eshte specitikuar se kërkohet Ix 4 TB HDD, ka qene e pranueshme për komisionin vlerësues oferta me 3 disqe ne total me 4 TB.

Si përfundim, bazuar ne sqarimet profesionale te profesionisteve te teknologjisë nga DSISH si njësi e kërkesës, pretendimet e OE nuk qëndrojnë pasi qe ne OE i përzgjedhur nga ana e Komisionit ka te plotësuar kriteret e përcaktuar nga Kontrata Kornizic e AQP si dhe Kërkesat shtese te kërkua nga ana e DSISH -it. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv

Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 26.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1251/24, ndërsa me datë 09.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1251 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-se të mbetet në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, dhe po ashtu OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.e.

Lidhur me pretendimet e OE “STORM ICT” L.L.C.,- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1251 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar 390,000.00€.

AK me dt. 04.11.2024 përmes sistemit te prokurimeve elektronike ka publikuar/dërguar ftesën për ofertim tek OE dhe GOE të parakualifikuar nga ana e AQP-së sipas marrëveshjes publike kornizë me titull “Furnizimi me Pajisje të IT-së” dhe me numër te prokurimit: “UA/2016-24-3927-1-1-1”, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 15.11.2024 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar nëntë operator ekonomik në mesin e tyre edhe OE ankues

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë me dt. 02.12.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për kontratë ka rekomanduar OE Aritech Sh.P.K. - Graçanicë me ofertë të përgjithshme në vlerë prej 245,519.60 euro.Ndërsa ofertën e OE ankues komisioni i vlerësimit e ka vlerësuar si ofertë të pasukseshme.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt. 06.12.2024 brenda afatit ligjor. AK me dt.12.12.2024 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pa-bazuar, duke e arsyetur vendimin e saj lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues. Vlenë të ceket fakti se oferta OE të rekomanduar për kontratë është më e lire se oferta e OE ankues me diferencë prej 18,648.00€. OE i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt.

20.12.2024 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues pretendon se OE të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sepse nuk i ka përmbushur specifikimet teknike dhe se komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 par 4 kur e ka rekomanduar për kontratë.

Eksperti teknik dhe shqyrtues sqaron se, pretendimet ankimore nga ankesa e GOE “Storm ICT L.L.C. & Safebit L.L.C.”:

GOE Ankues pretendon se gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteti të prokurimit publik e deri në nxerrjen e njoftimit mbi vendimin, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së:

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Paragrafi 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktjnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti Kontraktues (Ministria e Shëndetësisë) pas analizimit të ofertave ka derguar tek Operatorët Ekonomik Njoftimin për vendimin e AK-se, ku shperblen me kontrate OE: Aritech SH.P.K.

Ne pas kërkesës për casje në dokumentacionin e ofertuesëve, konkretisht OE Aritech SH.P.K dhe pas analizimit të ofertës së tyre kemi vërejtur se oferta e OE nuk është e përgjegjshme dhe nuk është në përputhje me specifikat minimale të kërkuara në ftesën për ofertim të derguar nga AK (Ministria e Shëndetësisë). Pretendimet tona janë si më poshtë:

Pika 1.: Sipas Aneksit 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, AK ka kërkuar specifikat baze sipas kontratës së AQP-se me nr. të kontratës UA/2016-24-3927-1-1- 1/C549 deri C568, dhe ka kërkuar disa specifika me të avancuara si në tabelën më poshtë:

Pas analizimit të ofertës së OE: Aritech SH.P.K kemi vërejtur se OE nuk është në përputhje me kërkesën e AK-se.

Brand Name PC Model I:

Sipas ofertës teknike të dorëzuar, OE në fjalë ka ofertuar modelin “HP ProTower 290 G9” I cili nuk ka porte HDMI+DP por ka portet HDMI+VGA, ku edhe sipas katalogut zyrtar të dorëzuar

ka nenvizuar modelin “HP ProTower 290 G9” I cili shihet qarte se ne pjesen mbrapa nuk ka porte HDMI + DP por vetem HDMI + VGA, gjithashtu nuk e ka portin DP si port opsional qe mund te shtohet gjate konfigurimit nga prodhuesi. Modeli i cili duhet te ishte i ofertuar dhe qe ploteson specifikat teknike te kerkuar nga AK sa i perket porteve per video eshte “HP ProTower 290 G9 PCI”.

Kurse ne oferten teknike te dorezuar nga OE ka deklaruar se modeli I ofertuar ka portet HDMI+DP, gje qe bie ndesh me katalogun zyrtar te prodhuesit.

Pas pranimit te vendimit te AK-se per kerkesen per ri-shqyrtim, kjo pike kthehet si e pa bazuar me arsyetimin se pas sqarimit te ofertes se OE qe rekomandohet per tu shpallur I suksesshem “ekziston mundesia qe te porositet pajisja me HDMI dhe DP port te integruar, kjo gje mund te gjendet ne katalogun e ofuruar si ne printscreen-in e bashkangjitur”.

Pas konsultimit me prodhuesin kemi konfirmim qe pajisja eshte e konfigurueshme me portet HDMI + DP por te modeli “HP ProTower 290 G9 PCI” I cili eshte I ofertuar nga ne si GOE dhe I njejti ka edhe USB Porte te ndryshme prej modelit “HP ProTower 290 G9”. Gjithashtu me poshte mund te gjeni dokumentin zyrtar nga prodhuesi se modeli “HP ProTower 290 G9 PCI” vjen me porte te videos baze HDMI + DP, kurse modeli “HP ProTower 290 G9” qe OE ne fjale ka ofertuar sipas edhe katalogut te dorezuar faqe 2 konkretisht eshte e cekur qarte portet HDMI dhe VGA. Bazuar ne pergjigjen e AK-se per kete pretendim se eshte theksuar: “ku tek kartela grafike eshte sqaruar se ekziston mundesia qe te porositet pajisja me HDMI dhe DP port te integruar”. Ne kete raste eshte e mundur qe te konfigurohet vetem tek modeli “HP ProTower 290 G9 PCI” dhe jo tek “HP ProTower 290 G9” qe OE ne fjale ka ofertuar, qe nenkupton se keto 2 modele te kesaj platformen perveq porteve te videos kane edhe USB porte te ndryshme nga njera tjetra dhe qe nenkupton se OE qe rekomandohet te shpallet fitues duhet te nderroj modelin gje qe eshte ne kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Bazuar ne datasheet-in e dorezuar nga OE ne fjale qe pretendohet te shpallet fitues verehet se ne baze te USB Porteve te ofertuara dhe modelin te hijezuar eshte ofertuar modeli “HP ProTower 290 G9”, eshte argumentuar ne katalogun e ofertuar ku ne faqen 1 verehet OE ka hijezuar modelin “HP ProTower 290 G9 Desktop PC” gjithashtu ne faqen e pare jane hijezuar “Front: (4) SuperSpeed USB 5Gbps signaling rate port1”, ne faqen e dyte jane selektuar portet mbrapa “Connector (4) USB 2.0 port” dhe RJ-45 Network, ku ne te njejten faqe jane te specifikuar ne piken 4 dhe 5 portet VGA Port dhe HDMI Port si porte baze qe ky model i ka, me poshte po I bashkangjesim ne printscreen edhe faqet e hijezuara.

Faqja e pare ku jane te hijezuara modeli dhe USB Portet.

Ne faqen 9 te katalogut te dorezuar nga OE ne fjale, eshte mudnesia e identifikimit te USB porteve te modeleve ne fjale (HP ProTower 290 G9 dhe HP ProTower 290 G9 PCI) duke u saktësuar numri I llojeve I porteve (Front) ne te dy platformat te cilat jane porte baze nga prodhuesi. Me poshte po e bashkangjesim printscreen te kesaj faqe nga katalogu I dorezuar nga OE ne fjale.

Ne kete printscreen mund te verejme se portet e ofertuara nga OE ne fjale (front) “(4) SuperSpeed USB 5Gbps signaling rate port1” jane porte baze te modeleve sikur ne tabelen e po ketij katalogu, qe do te thote se portet e selektuara “(4) SuperSpeed USB 5Gbps 12th Gen PCI signaling rate port1” jane te vlefshme dhe porte baze vetem per modelet 13th/14th Gen NON-PCI si dhe tek modeli.

Kurse per portet mbrapa (rear) edhe njehere sic jane paraqitur ne faqen e dyte portet e modelit HP ProTower 290 G9, ku ne printscreen mund te verehen edhe nje here keto porte.

Gjithashtu ne oferten teknike te dorezuar nga OE per Brand Name PC Model I, eshte bere pershkrimi I USB porteve gabim pasi qe modeli I ofertuar nuk ka 4x USB 3.2 (10Gbps) por i ka 4x 3.1 (5Gbps) sipas katalogut zyrtar te prodhuesit.

Pika 2.: Brand Name PC – Model IV

Modeli i ofertuar nga OE, “HP Elite Tower 800 G9”, sipas katalogut zyrtar te prodhuesit dhe nenvizimeve qe ka bere OE shihet qarte se ky model nuk perkrah diskun 4TB HDD po maksimumi I diskut qe perkrah HDD eshte 2TB.

Kurse OE ne tabelen e specifikemeve teknike ka deklaruar se modeli i ofertuar ka 1TB SSD NVMe M.2 dhe 4TB HDD.

AK ne pergjigjen per kerkesen per ri-shqyrtim, kete pike na pretendon si te pa-bazuar me arsyetimin: “Perderisa ne termat e references nuk eshte specifikuar se kerkohet 1x 4TB HDD, ka gene e pranueshme per komisionin vleresues oferta me 3 disqe ne total me 4TB”.

Ne besojmë se ky arsyetim do te kete shume probleme tek perdoruesit e ketyra PC-ve pasi qe per secilen pajisjet do te krijohen 4 hapesira te ndryshme (1x 1TB SSD, 1x 2TB HDD, 1x 1TB HDD dhe 1x 1TB HDD) per ruajtjen e shënimeve.

Ne kërkojmë nga Eksperti I OSHP-se qe caktohet per kete lende, te beje verifikim e sakte te ketyre pikave qe ne pretendojme se jane ne kundërshtim me kerkesen e AK-se si dhe te beje verifikimin me prodhuesin te cilin OE ka ofertuar nese produktet ofertuara jane me garancion te plote nga prodhuesi sipas kerkeses se AK-se, pasi qe kerkesa per garancion nga prodhuesi ka gene pjese e kerkeses fillestare per para-kualifikim ne AQP Marreveshjen Kornize me nr. te prokurimit: UA/2016-24-3927-1-1-1 (Aneksi 7 - Formulari i autorizimit të prodhuesit) ku saktesisht kerkohen te dhenat si ne fotografine me poshte;

Pergjigjet e ekspertit teknik në pretendimet ankimore

Eksperti teknik pas pranimit te autorizimit dhe dokumenteve te nevojshme nga ana e ekspertit shqyrtues të prokurimit, të njejtat i ka analizuar dhe pas analizimit te ankesës, dokumenteve përcjellëse dhe rrjedhës së aktivitetit të prokurimit në përgjithësi, eksperti teknik ka pasur fakte te mjaftueshme që të shqyrtojë ne detaje të dy pretendimet ankimore dhe të njejtave te i’u përgjigjet me fakte, dhe në fund të jep rekomandimin e tij për Panelin Shqyrtues të OSHP-së.

Në total janë dy pretendime ankimore, të drejtuara kundër produkteve 3 dhe 4 nga tabela e kërkuar nga AK, konkretisht, pretendime që produktet në tabelën e mëposhtme nuk i plotësojnë kërkesat minimale dhe teknike të kërkuara.

Pretendimi ankimor 1

Eshtë i drejtuar ndaj produktit te ofertuar nga OE i propozuar për pozicionin 3, konkretisht “Brand Name PC – Model I”. OE ankues pretendon se OE i propozuar ka ofruar produktin i cili nuk e plotëson kërkesen minimale lidhur me 2 porte (HDMI dhe DP) dhe numrin e USB porteve

Citohet nga ankesa: ... OE ne fjale ka ofertuar modelin “HP ProTower 290 G9” I cili nuk ka porte HDMI+DP por ka portet HDMI+VGA, ku edhe sipas katalogut zyrtar te dorezuar ka nenvizuar modelin “HP ProTower 290 G9” I cili shihet qarte se ne pjesen mbrapa nuk ka porte HDMI + DP por vetem HDMI + VGA, gjithashtu nuk e ka portin DP si port opsional qe mund te shtohet gjate konfigurimit nga prodhuesi. Modeli i cili duhet te ishte i ofertuar dhe qe ploteson specifikat teknike te kerkuar nga AK sa i perket porteve per video eshte “HP ProTower 290 G9 PCI”.

Pergjigjet e ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti teknik e ka analizuar dosjen e dorëzuar nga OE i propozuar, ku ndër të tjera e ka gjetur edhe katalogun e detajuar të bashkëngjitur ofertes së tij, konkretisht dokumentin “Quickspecs” ne formatin pdf me titull “Pozicioni 3 - PC Model I.pdf”, i njejt specifikacion mund te konfirmohet edhe ne vegezen zyrate te publikuar nga prodhuesi:

<https://h20195.www2.hp.com/v2/GetDocument.aspx?docname=c08174111>

Në këtë vegëz, ashtu si edhe në datasheet-in e bashkëngjitur në ofertë, të gjitha specifikat kryesore janë identike dhe mendoj që OE i propozuar ka ofertuar me produkt që i plotëson kërkesat minimale të kërkuara dhe nuk kam gjetur dallime në mes të dy modeleve të cilat i ka cekur OE ankues e as nuk bëhet fjalë për ndërrim modeli, shih faqen e parë të dokumentit të bashkëngjitur dhe faqën e parë të dokumentit të shkarkuar:

Po ashtu e konfirmoj edhe mundësinë që ky produkt të përkrahë, perpos portit HDMI edhe Display port, këtë e kanë cekur edhe AK në përgjigjen e tyre: pjesa nga përgjigja në kërkesën për rishqyrtim të AK-së, lidhur me kete pjese te pretendimit ankimor 1:

Kjo konfirmohet po ashtu edhe në faqen 17 te të njejtit datasheet, shih në vijim:

Si dhe modeli i kartelës grafike të ofruar me këtë produkt dhe përkrahja e portëve në fjalë:

Andaj lidhur me pretendimin ankimor për Display Port, propozoj që të refuzohet si i pabazuar pasi që është konfirmuar që produkti mund të liferohet me kartelën grafike me portin e kërkuar nga datasheet zyrtar, dhe kjo si nga ekipi profesional i AK-se gjatë procesit te vlerësimit dhe shqyrtimit te kërkesës për rishqyrtim, po ashtu konfirmohet edhe në katalogun e ofruar nga vetë OE ankues në oferten e tij.

Pjesa e pretendimit ankimor kundër numrit USB portëve të produktit të ofertuar nga OE ankues për pozicionin 3, Brand Name PC – Model I, citohet nga ankesa:

Bazuar ne datasheet-in e dorezuar nga OE ne fjale qe pretendohet te shpallet fitues ... gjithashtu ne faqen e pare jane hijezuar “Front: (4) SuperSpeed USB 5Gbps signaling rate port1”, ne faqen e dyte jane selektuar portet mbrapa “Connector (4) USB 2.0 port” dhe RJ-45 Network, ku ne te njejtjen faqe jane te specifikuar ne piken 4 dhe 5 portet VGA Port dhe HDMI Port si porte baze qe ky model i ka ...

Sipas kërkesës se AK-së janë kërkuar në total 6 USB porte, 4 porte minimum USB 3.0 dhe 2 porte minimum 2.0, apo me të avancuara, OE i propozuar ka ofertuar me produkt i cili i ka 4 USB porte 5 Gbps, ekuivalent me USB 3.1 dhe 4 porte USB 2.0, te cilat janë me të avancuara se sa kërkesa.

Një gjë e tillë është konfirmuar edhe nga AK në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim dhe po ashtu edhe nga datasheet i produktit të ofertuar, për konfirmim të kësaj po i paraqes në vijim pjesë nga datasheet, pjesa e përparme:

Po ashtu edhe nga pjesa e pasme e produktit, ku konfirmohen edhe 4 porte tjera USB:

Andaj edhe në këtë pjesë propozoj që pretendimi ankimor të refuzohet si i pabazuar nga ana e panelit shqyrtues.

Ndërsa sa i përket pretendimit kundër dokumentit Specifikimit teknik të ofruar nga OE i propozuar, në të cilin janë të grumbulluara si në rastin e mëposhtëm numri i USB portëve, mendoj që OE i propozuar këtë e ka bërë ashtu që ta nxisë AK-në të shikoj në menyrë të detajuar dokumentet e ofruara si deshmi nga OE, prandaj në këtë pikë mendoj që kjo pjesë e pretendimit ankimor duhet të aprovohet si i bazuar, dhe mundësisht të eliminohet praktika që tek kolona e specifikave të produktit të ofertuar të kopjohen specifikat e kërkuara nga ana e AK-së, kjo shkakton huti tek komisionet vlerësuese dhe mundet të ju humb kohë të njejtëve për verifikimin.

Pretendimi ankimor 2

Është i drejtuar ndaj produktit të ofertuar nga OE i propozuar për pozicionin 4, konkretisht “Brand Name PC – Model IV”. OE ankues pretendon se OE i propozuar ka ofruar produktin i cili nuk e plotëson kërkesën minimale lidhur me citoj: ... Modeli i ofertuar nga OE, “HP Elite Tower 800 G9”, sipas katalogut zyrtar të prodhuesit dhe nenvizimeve që ka bërë OE shihet qarte se ky model nuk përkeqëson diskun 4TB HDD por maksimumi i diskut që përkeqëson HDD është 2TB.

Përgjigja e ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2

Eksperti teknik ka analizuar pretendimin ankimor dhe ka kontrolluar katalogun e ofruar nga OE i propozuar së bashku me ofertën e tij, konkretisht dokumentin me titull “Pozicioni 4 - PC Model IV.pdf”, dhe e konfirmoj që OE i propozuar për këtë pozicion ka ofertuar me produktin “HP Elite Mini 800 G9 Desktop PC”. Në vijim është vegëza për shkarkimin e dokumentit të njejtë nga faqja zyrtare e prodhuesit:

<https://h20195.www2.hp.com/v2/GetPDF.aspx/c08017769.pdf>

Sa i përket pretendimit lidhur me kapacitetin e diskut të ofruar, kërkesa e AK për këtë pikë është:

Kurse OE i propozuar, konkretisht produkti me të cilin ai ka ofertuar, sipas datasheet të bashkëngjitur ofronë këtë kapacitet:

Pra në total ka ofruar 1 disk SSD me kapacitet 1TB dhe 3 disqe tjera HDD me kapacitet total 4TB, pasi që në kërkesën e AK-së nuk është e kërkuar se me sa disqe duhet të ofrohet kapaciteti i kërkuar, atëherë mendoj që produkti i ofertuar nga OE ankues është në përputhje me kërkesën dhe i plotëson nevojat paraqitura nga AK. Prandaj për këtë pjesë propozoj që pretendimi ankimor të refuzohet si i pabazuar nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Pjesa e fundit e pretendimit ankimor 2 është drejtuar kundër garancionit të kërkuar nga AK “3 vite pas liferimit”, citoj pjesë nga ankesa ... “si dhe të beje verifikimin me prodhuesin të cilin OE ka ofertuar nëse produktet ofertuar janë me garancion të plotë nga prodhuesi sipas kërkesës së AK-së, pasi që kërkesa për garancion nga prodhuesi ka qenë pjesë e kërkesës fillestare për para-

kualifikim ne AQP Marreveshjen Kornize me nr. te prokurimit: UA/2016-24-3927-1-1-1 (Aneksi 7 - Formulari i autorizimit të prodhuesit) ku saktësisht kerkohen te dhenat si ne fotografine me poshte”.

Eksperti teknik pas krahasimit të përmbajtjes së kërkesës për rishqyrtim, konstaton së kjo pjesë e pretendimit nuk ka qenë pjesë apo nuk është cekur fare në kërkesën për rishqyrtim, por megjithatë eksperti teknik e ka shqyrtuar dhe konstaton se OE i propozuar, i cili paraprakisht është kualifikuar nga ana e AQP-së, më ç’rast nënkuptohet që janë plotësuar të gjitha kushtet dhe kërkesat nga ana e tij, së bashku me ofertën e tij për këtë aktivitet të prokurimit ka bashkëngjitur edhe deklaratën për garancion sipas kërkesës së ftesës për ofertim, dhe e njejta i përmbushë kërkesat që rrjedhin nga ajo, shih në vijim:

Andaj propozoj që edhe në këtë pikë pretendimi ankimor të refuzohet si i pabazuar nga ana e Panelit shqyrtues të OSHP-së.

Si përfundim, Eksperti shqyrtues dhe teknik sqaron se, lidhur me çështjen e ngritur, objekt i kësaj ankese, vlen të theksohet se komisioni për vlerësimin e ofertave ka vepruar në pajtim me nenin 59 par 4 kur ka rekomanduar për kontratë OE Aritech, pasi që i njejti i plotësonë specifikimet teknike dhe ka ofertuar me çmimin më të ulët. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se edhe pretendimet e pales në ankesë janë për këtë pikë janë të paqëndrueshme.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “STORM ICT” L.L.C Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “STORM ICT” L.L.C janë pjesërisht të bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur besimin konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates, 02.12.2024, për shpërbllim me kontratë operatorin ekonomik për aktivitetin e prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar ,Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me kompjuter dhe laptopa per nevoja te DSISH” me nr. të prokurimit: 206-24-11609-5-5-8, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2024/1251, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizim me kompjuter dhe laptopa per nevoja te DSISH” me nr. të prokurimit: 206-24-11609-5-5-8..

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat

dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishëm të ankesës të OE "STORM ICT" L.L.C, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - STORM ICT L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: